



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivery	13.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6171/2022		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.651/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben mehemetiu dhe Ardita Haxhnikaj Demi, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.42/2020, të datës 13.09.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr 651/2019 të datës 23.10.2019 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.651/2019 e datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Njoftimi për kandidatin e suksesshme me numër protokolli 7989 i datës 25.09.2019, i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

A r s y e t i m

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bazë të autorizimit të datës 21.08.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, me datë 23.08.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Metrologji" në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ne te cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është ftuar të marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 25.09.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 25.09.2019 për kandidaten e suksesshme, me datë 22.10.2019 ka parashtruar ankesë me nr. protokolli 8666.në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ndërsa Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë përmesë e-mailit të datës 22.10.2019 ka njoftuar ankuesin, gjegjësisht kandidatin që ka qenë pjesë e procesit të rekrutimit se palët të cilët eventualisht janë të pa kënaqur duhet të bëjnë ankesë në KPMSHCK për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik.

Ankuesi, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.10.2019 ka parashtruar ankesë numër protokolli 4995/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Zyrtar për Metrologji" .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 29.10.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa kjo e fundit me datë 31.10.2019 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 5107/2019 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 12.12.2019 me numër protokolli 5786/2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 05.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.42/2020, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 13.09.2022, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.12.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 23.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4995/2019 të datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim me numër protokolli 5786/2019 i datës 12.12.2019; Fletëkthesë e datës 13.12.2019; Fletëkthesë e datës 30.10.2019; Aktgjykimin A.nr.42/2020 i datës 05.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti

13-4
DSC
KATB
KOSO

për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 13.09.2022 me numër protokolli 5363/2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.10.2019; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 5107/2019 e datës 31.10.2019; E-mail nga A.D. për X.Z. i datës 22.10.2019; E-mail nga A.G. për H.G. etj. i datës 22.10.2019; Konkurs – Rekrutim me nr. protokolli 7001 për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 23.08.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 20.09.2019; E-mail nga A.D. për X.Z. i datës 25.09.2019; Njoftim për kandidatin e suksesshëm me numër 7989 i datës 25.09.2019; Dëshmi mbi pranimin e aplikacionit e M.Z. i datës 06.09.2019; Kërkesa për punësim e M.Z. i datës 05.09.2019; CV-ja e M.Z.; Raport trajnimi Era Med i datës 22.02.2017 deri 08.03.2017 1/3 faqe; Vërtetim nga Era Med për M.Z. i datës 01.01.2017 deri 01.02.2018; Vërtetim nga N.SH. Agrovet për M.Z. i datës 03.04.2007; Vërtetim nga Komuna e Malishevës për M.Z. me nr.11/776 i datës 25.07.2019; Certifikatë nga DAK për M.Z. i datës 14.02.2017; Certifikatë nga ECDL Foundation për M.Z. i datës 14.09.2010; Forma individuale për intervistë Form. MAP-SHCK-07b/ Form.MJU-CSK-07b për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 24.09.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Forma individuale për intervistë Form. MAP-SHCK-07b/ Form.MJU-CSK-07b për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 24.09.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Forma individuale për intervistë Form. MAP-SHCK-07b/ Form.MJU-CSK-07b për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 24.09.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Forma individuale për intervistë Form. MAP-SHCK-07b/ Form.MJU-CSK-07b për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 24.09.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Forma individuale për intervistë Form. MAP-SHCK-07b/ Form.MJU-CSK-07b për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 24.09.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” e M.Z. me numër 884 i datës 18.07.2018; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” e M.Z. me numër 80 i datës 02.05.2007; Autorizim nga DASHC/MAP i datës 21.08.2019; Vendim për themelimin e komisionit përzgjedhës me numër protokolli 02-2154 i datës 10.09.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 20.09.2019; E-mail nga A.D. për X.Z. i datës 25.09.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar Form. MAP-SHCK-04/Form.MJU-CSK-04; Formulari i vlerësimit të zgjedhjes së ngushtë për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i datës 12.09.2019; Të dhënat emrat e anëtarëve të komisionit për përzgjedhjen e listës së shkurtë; Testi me shkrim i kandidatës për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i S.A.Z.; Testi me shkrim i kandidatit për pozitën “Zyrtar për Metrologji” i M.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i S.A.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i S.A.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i S.A.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e

ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i S.A.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i M.Z.; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a/Form.MJU-CSK-08a i S.A.Z.; Letërnjoftim i M.Z.; Kërkesa për punësim e S.A. e datës 02.09.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e S.A. me numër 1895 i datës 31.12.2015; Certifikatë e S.A. me numër 949; Certifikatë e S.A nga MTI e datës 11.11.2016; Certifikatë e S.A nga Zas trade e datës 01.02.2011; Certifikatë e S.A nga Zas trade e datës 28.04.2011; Letërnjoftimi i S.A.Z.; Vërtetim nga "Burimi Comerc" shpk. për S.A. nga data 02.01.2015 deri me datë 30.11.2017; Vërtetim nga Agjencioni Turistik "Meni Travel" për S.A. nga data 03.05.2005 deri me datë 12.02.2007; Letër rekomandim nga "Burimi Comerc" shpk për S.A.; Vërtetim për trajnim për S.A. nga data 10.01.2007 deri me datë 12.04.2007; Vërtetim për trajnim për S.A. nga data 10.01.2007; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 24.09.2019; Ankesë e ankuesit M.Z. drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër protokolli 8666 e datës 22.10.2019; E-mail nga A.D. për X.Z. i datës 22.10.2019; E-mail nga A.G. për H.G. etj i datës 22.10.2019; E-mail nga A.D. për C.Z. i datës 04.10.2022; E-mail nga C.Z. për A.D. i datës 04.10.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form. MAP-SHCK-09/ Form.MJU-CSK-09; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form. MAP-SHCK-10/ Form.MJU-CSK-10; E-mail nga A.D. për C.Z. i datës 07.10.2022; E-mail nga C.Z. për A.D. i datës 07.10.2022; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për S.A. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për S.A. i datës 12.09.2019; Pjesmarrja e kandidatëve në testim me shkrim e datës 16.09.2019; E-mail nga B.B. për S.B. etj. i datës 20.09.2019; E-mail nga B.B. për X.Z. i datës 20.09.2019; E-mail nga B.B. për S.A. i datës 20.09.2019; E-mail nga B.B. për G.K etj. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për G.K. etj. i datës 12.09.2019; E-mail nga G.K. për B.B. etj. i datës 12.09.2019; E-mail nga B.B. për G.K. etj. i datës 12.09.2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi pretendon se kandidatja e zgjedhur për pozitën "Zyrtar për Metrologji" në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë sipas Njoftimit për kandidatin e suksesshëm me numër 7989 të datës 25.09.2019, nuk ka plotësuar kushtet për këtë pozitë, sepse e njëjta nuk ka pasur përvojën e punës prej dy (2) vite ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se kriteret themelore për pozitën "Zyrtar për Metrologji" në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kanë qenë:

- *Diplomë universitare: FSHMN Drejtimi i Fizikës Inxhinierike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;*
- *Minimum 2 vite përvojë pune profesionale;*

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit dhe kriterëve të konkursit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë ku përcaktohet se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës",.... secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes"*, andaj në rastin konkret Kolegji konstaton se në listën e ngushtë është përfshirë ankuesi dhe kandidati i përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në baze të dëshmive të ofruara ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit që lidhet me kualifikimin profesional dhe përvojën e punës të kandidatës së përzgjedhur, gjegjësisht ankuesi pretendon se kandidatja e përzgjedhur nuk e ka përvojën e punës, janë të pa qëndrueshme sepse kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës *"Zyrtar për Metrologji"* posedon: Diplomë Universitare me numër nr.1895 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës *"Hasan Prishtina"* të datës 31.12.2015 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Fizikes-Drejtimi Ixhinerik dhe mori titullin Bachelor i Fizikës Inxhinerike me date 25.11.2015 si dhe me përvojë pune si në vijim: nga data 02.01.2015 deri me 30.11.2017 në pozitën *"Asistente Laboratori"* në kompaninë *"Burimi Commerce"*; nga data 03.05.2005 deri me 12.02.2007 në pozitën *"Asistente Administrative"* në Agjencionin *"Meti Travel"* dhe se kandidatja e përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas konkursit të datës 23.08.2019, të shpallur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për vendin e punës *"Zyrtar për Metrologji"*, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, të cilat kanë qenë: *Diplomë universitare: FSHMN Drejtimi i Fizikës Inxhinerike, Fakulteti i Inxhinerisë Mekanik; dhe Minimum 2 vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitura në dosjen e kandidatës së përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatës së suksesshme për pozitën *"Zyrtar për Metrologji"* në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, duke u bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: *"Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes"*, sepse kandidatja e përzgjedhur i ka përmbushur kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kërkuara në konkursin e shpallur me datë 23.08.2019, për pozitën *"Zyrtar për Metrologji"* në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen

përfundimtare, ka vepruar drejtë duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesin, po ashtu edhe për kandidaten e përzgjedhur duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në bazë të vlerësimeve kandidatja e përzgjedhur ka arritë gjithsejtë 77.85% nga pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesi ka arritur e gjithsejtë 72.75% pikë të përgjithshme nga testit me shkrim dhe testit me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se përzgjedhja e kandidates është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”,* në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë nw Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës dhe ankuesi pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritë gjithsejtë 72.75% pikët e përgjithshme, dhe është renditur i dyti (2) në listën përfundimtare të kandidatëve.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, me datë 25.09.2019 ka publikuar njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare nga procedura e rekrutimit, gjegjësisht ka njoftuar për kandidaten e suksesshëm, duke vepruar në pajtim me nenin 41 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ashtu siç theksohet se : *“Institucioni përkatës është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit në faqe të internetit të institucionit. Njoftimi përmban emrat e kandidatëve të suksesshëm, vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurës së përgjithshme”,* andaj mbi këtë baze Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me pa rregullsitë e zhvilluara në këtë procedurë të rekrutimit, janë të paqëndrueshme.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesi, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën „Zyrtar për Metrologji“, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, të shpallur me datë 23.08.2019 nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, që nga shpallja publike e konkursit më datën 23.08.2019 e deri në shpalljen për publikimin e rezultateve të procedurës së rekrutimit ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”* dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”,* si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR. 651/2019

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-se